



AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE

RAPORTI VJETOR

2025

PËRMBAJTJA E LËNDËS

Hyrje.....	3-4
1. Vlerësimi dhe ekzekutimi i vendimeve përfundimtare që kanë njohur të drejtën e kompensimit.....	5
1.1. Përditësimi dhe vlerësimi financiar i vendimeve përfundimtare	5
1.2. Kompensimi financiar/fizik i vendimeve përfundimtare që kanë njohur të drejtën e kompensimit	5
1.3. Përfitimi i shpërblimit për pronat e zëna nga ndërtimet informale (ALUIZNI)	7
2. Trajtimi i kërkesave për njohje pronësie	7-8
3. Verifikimi, identifikimi dhe bllokimi i fondit të tokës për kompensim.....	9
4. Përfaqësimi Ligjor i ATP-së.....	9
5. Raportime institucionale	10
5.1. Raportime nga Asistenca Ligjore.....	10
5.2. Raportime institucionale në zbatim të Ligjit 133/2015	11
5.3. Raportime periodike mujore pranë ZOS për numrin e skanimeve dhe hartografimeve në ATP nga sistemi Web-Gis	11
6. Kërkesa/ankesa të trajtuara nga Agjencia e Trajtimit të Pronave	11
6.1. Trajtimi i shkresave pranë protokollit të ATP-së	11
6.2. Trajtimi i kërkesave/ankesave pranë ATP-së.....	12
6.2.1. Trajtimi i kërkesave/ankesave nga portali i Bashkëqeverisjes.....	12
6.2.2. Dokumente të trajtuar nga Sektori i Arkivës.....	12-13
6.3. Shërbime elektronike të ofruara nga ATP.....	13-14
7. Analiza e buxhetit dhe fondeve speciale të kompensimit.....	14
7.1. Analiza e Buxhetit të vitit 2025 (pa kuadruar nga Thesari).....	14-15
7.2. Informacion mbi të ardhurat nga tarifatat që aplikohen në ATP.....	16
7.3. Informacioni shpenzime për Aluiznin dhe Kompensim Financiar, dhe me raste të veçanta	17

Hyrje

Agjencia e Trajtimit të Pronave është institucion publik në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, i cili ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave.

Veprimtaria e Agjencisë mbështetet në Ligjin nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore përkatëse, konkretisht: Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 221/2016; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 222/2016, i ndryshuar; dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 223/2016, i ndryshuar.

Në ushtrim të kompetencave të saj, Agjencia ka për detyrë administrimin, shqyrtimin dhe vendimmarrjen lidhur me kërkesat për njohje, kthim dhe/ose kompensim të pronave, si dhe realizimin e procedurave për përmbylljen përfundimtare të procesit të kompensimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ligji nr. 133/2015 “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e kompensimit të pronave” është miratuar më 05.12.2015 dhe ka hyrë në fuqi më 23.02.2016. Ligji parashikonte një afat 3 (tre) vjeçar nga hyrja në fuqi për vlerësimin financiar të vendimeve përfundimtare dhe shqyrtimin e kërkesave për njohje pronësie, si dhe një afat 10 (dhjetë) vjeçar për ekzekutimin e vendimeve përfundimtare të vlerësuara financiarisht.

Me zbardhjen e vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 4, datë 15.02.2021, procesi i kompensimit financiar për vendimet përfundimtare në Agjencinë e Trajtimit të Pronave u pezullua dhe filloi puna për ndryshimet e ligjit nr. 133/2015.

Në bazë e për zbatim të ndryshimeve të miratuara, u bë i mundur vlerësimi financiar sipas rekomandimeve të dhëna nga GjEDNj për 3919 vendime me të drejtë kompensimi që kishin pësuar ndryshim të zërit kadastral, me një faturë të shtuar financiare prej rreth 16,015,625,979.13 lekë, (gjashtëmbëdhjetë miliard e pesëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e njëzet e pesë mijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë pikë trembëdhjetë lekë) si dhe u rivendos juridiksioni administrativ për trajtimin e dosjeve/praktikave të patrajtuara me vendim brenda afateve të përcaktuara në nenin 34 të Ligjit 133/2015. Për 6596 vendime të tjera të cilat kishin pësuar ndryshim të zërit kadastral, nuk pati ndryshim të vlerës së publikuar për arsye të ndryshme (*vendime për të cilat vlera sipas ligjit 133/2015 ishte më e madhe se sa vlera sipas ndryshimeve ligjore, vendime vetëm me të drejte parablerje, vendime me vlerë të përcaktuar në vendim etj*).

Në mbledhjen e datës 08.11.2023, Gjykata Kushtetuese, pasi mori në shqyrtim paraprak çështjen me nr. 18 (K) 2023 të Regjistrat Themeltar, me kërkesë Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, me objekt shfuqizimin e disa pikave të ligjit nr. 77/2022, datë 17.11.2022, vendosi pezullimin e zbatimit të këtij ligji, si dhe kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike.

Kjo masë procedurale, solli si pasojë pezullimin e plotë të proceseve të punës në ATP për një periudhë 3 mujore. Kjo vendimarrje e Gjykatës Kushtetuese, ndër të tjera, pati një efekt tejet demotivues, duke reduktuar ndjeshëm numrin e dosjeve të rikthyera për shqyrtim në ATP, krahas efektit financiar, ku fondit të kompensimit i'u shkaktua një dëm prej 2.34 mld lekë (Dy miliardë e treqind e dyzet milionë lekë) .

Gjykata Kushtetuese në datë 13.02.2024 vendosi rrëzimin e kërkesës së Komunitetit Mysliman të Shqipërisë dhe ATP rifilloi punën normalisht. Agjencia e Trajtimit të Pronave ka marrë të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme ligjore për vijueshmërinë normale të procedurave

administrative institucionale, ka kryer përditësim dhe publikim të rregullt të informacionit, duke përfshirë informacione për aktet dhe vendimet administrative ose gjyqësore.

Ligji nr. 12, datë 17.02.2025 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave” u botua në Fletoren Zyrtare nr. 44, datë 04.03.2025. Ndryshimet ligjore siguruan zgjatjen e afatit për trajtimin e kërkesave për njohje pronësie deri në datën 31.12.2027 si dhe procesi i pagesës për të gjitha vendimet përfundimtare që kanë të njohur të drejtën e kompensimit do të përfundojë deri në datën 31.12.2028.

Agjencia e Trajtimit të Pronave ka marrë të gjitha masat dhe veprimet e nevojshme ligjore për vijueshmërinë normale të procedurave administrative institucionale, ka kryer përditësim dhe publikim të rregullt të informacionit, duke përfshirë informacione për aktet dhe vendimet administrative ose gjyqësore. Përditësimet publikohen në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare si dhe në faqen zyrtare të internetit të ATP-së kryesisht www.atp.gov.al.

Agjencia e Trajtimit të Pronave, në zbatim të pikës 14 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 221, datë 23.3.2016, “Për mënyrën e funksionimit dhe organizimit të Agjencisë së Trajtimit të Pronave“, paraqet raportin vjetor të punës për periudhën Janar – Dhjetor 2025.

1. Vlerësimi dhe ekzekutimi i vendimeve përfundimtare që kanë njohur të drejtën e kompensimit

Agjencia e Trajtit të Pronave, nga hyrja në fuqi e ligjit 133/2015 deri në mbylljen e procesit të vlerësimit, ka ndërmarrë procedurat administrative të vlerësimit financiar për **27 023 vendime** përfundimtare për kompensim të viteve 1993 – 2013. Të gjitha përditësimet janë bërë publike në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare.

1.1. Përditësimi dhe vlerësimi financiar i vendimeve përfundimtare

- ▶ **20,541 vendime** u vlerësuan financiarisht.

Vlera totale e vendimeve me të drejtë kompensimi të vlerësuar financiarisht është **120,876,550,395.09 lekë** (Njëqind e njëzet miliardë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë milionë e pesëqind e pesëdhjetë mijë e treqind e nëntëdhjetë e pesë presje nëntë lekë). Kjo vlerë pritet të ndryshojë pasi ATP është në pritje të përfundimit të ankimeve nga subjektet në bazë të afateve ligjore.

- ▶ **2469 vendime** për të cilat subjekti konsiderohet i kompensuar, vlera prej – 25,610,343,784.83 lekë (minus njëzet e pesë miliardë e gjashtëqind e dhjetë milionë e treqind e dyzet e tre mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e katër presje tetëdhjetë e tre lekë).
- ▶ **838 vendimet** e fshira gjatë procesit të rivlerësimit të vendimeve.
- ▶ **3,921 vendimet** e prekura nga ndryshimet ligjore dhe fatura financiare është rritur me **16,378,825,523.15 lekë** (gjashtëmbëdhjetë miliardë e treqind e shtatëdhjetë e tetë milionë e tetëqind e njëzet e pesë mijë e pesëqind e njëzet e tre presje pesëmbëdhjetë lekë) pas ndryshimeve ligjore.

1.2. Kompensimi financiar/fizik i vendimeve përfundimtare që kanë njohur të drejtën e kompensimit

Nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 133/2015, janë depozituar **2,633 kërkesa** për kompensim financiar dhe fizik, nga të cilat janë ekzekutuar **35.74%**, përkatësisht **941 vendime**, me një vlerë totale prej **8,948,015,755.98 lekë** (tetë miliardë e nëntëqind e dyzet e tetë milionë e pesëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e pesë presje nëntëdhjetë e tetë lekë) . Nga këto, **94 vendime** janë mbyllje procedimi, ndërsa është shpërndarë gjithashtu një sipërfaqe prej **8,923,014.24 m2 (892.3 hektarësh tokë)** tokë nga fondi fizik. Pjesa e mbetur e kërkesave nuk është ekzekutuar kryesisht për shkak të mungesës së dokumentacionit të nevojshëm, vonesave nga ndryshimet ligjore, mungesën e deklaratave noteriale, problematika të lidhura me tagrin e prokurave dhe çështje të tjera administrative që kanë penguar përfundimin e procedurave ligjore.



Evidencë e ndarjes demografike të vendimeve për kompensim

Forma e kompensimit	Drejtoria. e kompensimit
Kompensim me skemën 20/80	37
Kompensim me kërkesë të veçantë	27
Mbyllje procedimi	7
Totali	71

Gjatë vitit 2025, Agjencia e Trajtimit të Pronave ka vijuar me procesin e kompensimit financiar dhe fizik, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi përmes mekanizmave të përcaktuar për kompensimim dhe rezultton:

Gjatë periudhës **Janar – Dhjetor 2025**, për Kompensimin Financiar dhe Fizik dhe Kompensim me Kërkesë Veçantë, rezultton:

Kompensim deri në 1,500,000 lekë	
Nr. i vendimeve të ekzekutuara	27
Vlera e ekzekutuar	21,046,726.28 lekë
Kompensim me kërkesë të veçantë 40%	
Nr. i vendimeve të ekzekutuara	27
Përfitimi total për subjektet	475,497,329.41 lekë
Kësti i parë i ekzekutuar	95,099,465.87 lekë
Vlera e kursyer për buxhetin e shtetit	786,600.555,11 lekë
Nr. i dosjeve që përfitojnë këstet e rradhës	32
Vlera e ekzekutuar për këstet e rradhës	162,056,379.76 lekë
Mbyllje procedimi administrativ	1
Nr. i dosjeve të reja të pranuar	30
Kompensim financiar dhe fizik 20/80	
Nr. i vendimeve të ekzekutuara	10
Vlera e ekzekutuar	36,945,156.44 lekë
Vlera e përfituar fizikisht	155,400,888.38 lekë
Sipërfaqja e kompensuar fizikisht	1,276,310.59 m ²
Mbyllje procedimi administrativ	6
Nr. i dosjeve të reja të pranuar	61


1.3. Përfitimi i shpërblimit për pronat e zëna nga ndërtimet informale (ALUIZNI)

Në zbatim të VKM-së nr. 383 datë 19.05.2010 “Për përcaktimin e procedurave të shpërndarjes së fondit të kompensimit në vlerë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga ndërtimet informale”, të ndryshuar, që prej fillimit të procesit janë miratuar 87 VKM në bazë të së cilave miratohen listat e subjekteve përfituese dhe pasurive përkatëse. Sipërfaqja e trajtuar nga këto VKM është 3,761,513.58 m². Pranë ATP-së janë administruar kërkesat e 14,667 subjekteve për përfitim të kompensimit, nga të cilat 8,847 janë subjekte përfituese me vlerën 100%, 1,480 janë subjekte në pritje të kështit të fundit 30%, 4,340 në shqyrtim për kështin 70% .

Përgjatë vitit 2025 janë miratuar 2 VKM dhe janë paraqitur 1296 aplikime nga subjektet. ATP kreu ekzekutimin e kështit të fundit në masë 30% për 3527 dosje, vlera e të cilave shkon në **1,396,651,400.49 lekë** (një miliard e treqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e një mijë e katërqind presje dyzet e nëntë lekë).

Gjatë vitit 2025 janë ekzekutuar 626 aplikime në masë 70% me vlerë **677,585,966.14 lekë** (gjashtëqind e shtatëdhjetë e shtatë milionë e pesëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë presje katërmëdhjetë lekë).

Evidencë e trajtimit të aplikimeve për kompensim nga ALUIZNI gjatë vitit 2025



2. Trajtimi i kërkesave për njohje pronësie

Pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave, aktualisht janë në proces shqyrtimi rreth **6755** dosje dhe praktika (nga të cilat 810 janë dosje dhe praktika të rikthyera për trajtim pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave sipas përcaktimeve në nenin 9, pika 2 i ligjit 77/2022),

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr.77/2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.133/2015”, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, afati i përcaktuar në nenin 34 pika 1 i cili parashikonte se: Nëse ATP-ja nuk përmbush detyrimin për

të trajtuar kërkesat e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, brenda afatit 3-vjeçar, atëherë subjektet mund t'i drejtohen gjykatës së shkallës së parë për të trajtuar kërkesën e tyre, u zëvendësua brenda datës 31.12.2024”.

Ndërsa me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 12, datë 17.02.2025 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, i ndryshuar”, ky afat u zëvendësua me brenda datës 31.12.2027 dhe ATP-ja ka rifilluar menjëherë procesin e trajtimit të kërkesave për njohje pronësie.



Për periudhën Janar – Dhjetor 2025, Drejtoria e Trajtimit të Kërkesave për Njohje Pronësie ka kryer:

- Kthim përgjigje shkresa zyrtare **38**;
- Kthim përgjigje shkresa qytetare **397**;
- Kthim përgjigje për kërkesa dhe ankesa nga portali e-Albania si dhe nga bashkëqeverisja **355**;
- Plotësime dokumentacioni në dosjet dhe praktikat e administruara **327**;
- Njoftime për plotësim dokumentacioni për dosjet dhe praktikat e administruara **159**;
- Trajtuar me vendim **78** dosje dhe praktika;
- Trajtuar me memo **23** dosje dhe praktika ;
- Në vijim, veprime proceduriale (njoftime, shpallje, kërkesa për konfirmime) në lidhje me trajtimin e kërkesave për njohje pronësie.

Gjatë vitit 2025, ATP ka trajtuar me vendim dosjet sipas qarqeve:

Qarku	Nr. i vendimeve
Berat	3
Durrës	12
Dibër	1
Elbasan	6
Fier	15
Gjirokastrë	12
Korçë	7
Kukës	3
Lezhë	1
Shkodër	2
Tiranë	13
Vlorë	26

3. Verifikimi, identifikimi dhe bllokimi i fondit të tokës për kompensim

Për periudhën Janar - Dhjetor 2025, Sektori i Verifikimit të Fondit Fizik, në zbatim të nenit 12, të ligjit 133/2015, “Për Trajtimin e Pronës dhe Përfundimin e Procesit të Kompensimit të Pronave”, të ndryshuar, ka kryer këtë veprimtari:

Korrespondencë me institucione dhe me subjekte private për Fondin Fizik në dispozicion të ATP-së, lidhur me numra pasurie si për numra pasurie me interes për zhvillim/ndryshim, ashtu edhe për ato në proces kompensimi për subjektet e shpronësuara me vendime përfundimtare;

Komunikim zyrtar me institucione shtetërore, subjekte qytetare dhe sektorët e brendshëm të ATP-së për konfirmimin e statusit të disa numrave pasurie, nëse janë pjesë e Fondit Fizik apo jo;

Në zbatim të VKM-së nr.1077/2008, “Për krijimin e fondit të kompensimit fizik nga fondi pyjor dhe kullor”, është bashkëpunuar me institucione të ndryshme shtetërore për marrjen e hartave të ekonomive pyjore, dhe bazuar në hartat e marra, është vazhduar procesi i përpilimit dhe hedhjes së tyre në platformën e ATP-së, Web-GIS për rreth 187 ekonomi pyjore/kullorore (pasuri) të ndodhura në qarqet Tiranë dhe Vlorë (konkretisht ekonomitë pyjore/kullorore Rrëzomë, ekonomitë pyjore Krabë-Gurë dhe Rove-Lunxhe & ekonomia kullorore Bregdet);

Gjithashtu janë kryer verifikimet në terren për rreth 420 ngastra të ekonomive pyjore dhe kullorore që ndodhen nën juridiksionin administrativ të Bashkive Fier, Roskovec, Mallakastër, Kuçovë, Patos, Delvinë, Finiq, Himarë dhe Dimal.

4. Përfaqësimi Ligjor i ATP-së

Një nga veprimtaritë e ATP-së është dhe mbrojtja e interesave të saj në tre shkallët e gjyqësorit dhe në gjykatën Administrative për vendimet e dhëna ndër vite. Nga Përfaqësimi Ligjor pranë gjykatave të Republikës së Shqipërisë, rezultojnë:

- Çështje në ndjekje në total: 2039
- Çështje në ndjekje në rrethin e Tiranës: 791
- Çështje në ndjekje në rrethet e tjera të RSH: 1338

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2025 rezultojnë se:

- Janë depozituar 255 padi në të gjitha gjykatat e vendit;
- Janë mbyllur me vendim 289 padi;
- Janë rrëzuar 68 padi;
- Kanë përfunduar me kthimin e akteve apo me pushimin e padis 107 padi;
- Janë ushtruar 30 ankime dhe 46 rekurse, total 76.

Duke patur në vëmendje ndryshimet ligjore dhe kryesisht të akteve nënligjore që përcaktojnë procedurat dhe rregullat e vlerësimit financiar të vendimeve përfundimtare që kanë njohur të drejtën e pronës të dhënat e mësipërme mund të konsiderohen si një ecuri pozitive e veprimtarisë së përfaqësimit ligjor pranë gjykatave dhe në veçanti në juridiksionin administrativ.

5. Raportime institucionale

Agjencia e Trajtimt të Pronave në funksion të procesit të njohjes dhe kompensimit të pronës, bashkërendon veprimtarinë me Agjencinë Shtetërore për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG), Arkivin e Shtetit, Arkivin Qendror Teknik të Ndërtimit, organet e pushtetit vendor dhe çdo institucion tjetër, veprimtaria e të cilit lidhet apo ka përgjegjësi për këtë proces.

5.1 Raportime nga Asistenca Ligjore

Gjatë periudhës raportuese, janë regjistruar gjithsej 439 kërkesa zyrtare, të cilat kanë pasur për qëllim marrjen e informacionit mbi çështje të ndryshme ligjore si më poshtë

Institucioni	Nr. i kërkesave
Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve	39
Agjencia Shtetërore e Kadastrës	250
Bashkitë	27
Ministri të ndryshme	40
Korporata Shqiptare e Investimeve	24
Gjykata, Prokurori, Avokatura	38
Ndërmarrja Industriale, Dega Shoqërive Publike, Enti kombëtar i banesave	10
Këshilli i Qarkut, Prefekti	4
Institucione të tjera	7
Spektori i Përfaqësimit Ligjor	155
Totali i kërkesave të trajtuara për vitin 2025	594

5.2 Raportime institucionale në zbatim të Ligjit 133/2015

Raportime institucionale pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe referuar shkresave dhe informacionit të kërkuar për çështjen e pronave, si vijon:

- Raportim periodik institucional pranë Ministrisë së Drejtësisë, Kryeministrisë dhe Kuvendit sipas përcaktimit në ligjin 133/2015;
- Kontributi i ATP-së në takimet e Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integrimin Evropian për Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore”;
- Raportim në ZOS (Zyra Operacionale për Situatën) në Kryeministri për indikatorët e- shërbime ndaj qytetarëve si dhe indikatorët skanime/hartografime;
- Kontributi i ATP-së mbi Takimin e 15-të të Nënkomitetit për "Tregtinë, Industrinë, Doganat dhe Tatimet”;
- Raportim mbi ecurinë e zbatueshmërisë së masave lidhur me monitorimin e Udhërrëfyesit të Shtetit të së Drejtës;
- Kontributi i ATP-së për raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë, për vitin 2025;
- Raportim pranë Ministrisë së Financave në lidhje me Due Diligence;

5.3 Raportime periodike mujore pranë ZOS për numrin e skanimeve dhe hartografimeve në ATP nga sistemi Web-Gis.

Nga evidencat e raportimeve mujore pranë ZOS, për periudhën **Janar – Dhjetor 2025**, rezulton se janë kryer **202 skanime** të vendimeve si dhe **45 hartografime**.

Indikatori	3M I	3M II	3M III	3M IV	Total
Skanime	103	55	17	27	202
Hartografime	7	12	1	5	25

6. Kërkesa/ankesa të trajtuara nga Agjencia e Trajtimit të Pronave

6.1. Trajtimi i shkresave pranë protokollit të ATP-së

Për periudhën **Janar – Dhjetor 2025**, nga Sektori i Protokollit në ATP janë përpunuar dhe protokolluar shkresat hyrëse dhe dalëse, evidencimi i të cilave është pasqyruar në tabelën vijuese:

Indikatori	Treguesit statistikor	Janar - Dhjetor 2025
Trajtimi i shkresave në ATP	Nr. i shkresave hyrëse qytetare	5186
	Nr. i shkresave hyrëse zyrtare	5395
	Nr. i shkresave me përgjigje qytetare	3456
	Nr. i shkresave me përgjigje zyrtare	3110
	Nr. i shkresave të brendshme	3012
	Totali i shkresave	20159

6.2. Trajtimi i kërkesave/ankesave pranë ATP-së

6.2.1. Trajtimi i kërkesave/ankesave nga portali i Bashkëqeverisjes

Pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave janë trajtuar kërkesat dhe ankesat të paraqitura nëpërmjet Platformës së Bashkëqeverisjes me qytetarët.

Për periudhën **Janar – Dhjetor 2025**, janë trajtuar me përgjigje **231 kërkesa/ankesa** qytetarësh të paraqitura nëpërmjet Platformës së Bashkëqeverisjes, të trajtuara me përgjigje, nga të cilat:

- 61 kërkesë/ankesa të cilat kanë lidhje me procesin e Kompensimit Financiar/Fizik;
- 99 kërkesë/ankesa për procesin e shqyrtimit të kërkesave për kompensimin në vlerë të ish pronarëve, tokat e të cilëve janë zënë me ndërtime informale;
- 17 kërkesë/ankesa për Sektorin e Arkivës dhe Sherbimet Online;
- 45 kërkesë/ankesa për Sektorin e Shqyrtimit;
- 9 kërkesa për Drejtorinë Juridike/ Përfaqësimin ligjor.

6.2.2. Dokumente të trajtuar nga Sektori i Arkivës

Në Arkivën e ATP-së për periudhën Janar – Dhjetor 2025 rezulton se janë ruajtur, administruar dhe përpunuar 1643 dosje dhe praktika të cilat kanë zbritur në arkiv nga sektorët dhe janë hedhur në sistemin Web-GIS, të detajuara si vijon:

- 456 aplikime Zyrtare
- 796 aplikime Qytetare (legjitimim)
- 556 aplikime në e-albania+post

Janë realizuar përgjigjet e 1505 aplikimeve, nga të cilat:

- 452 aplikime Zyrtare
- 744 aplikime Qytetare (legjitimim)
- 309 aplikime në e-albania+post
- Janë administruar (marrë në dorëzim) **367** dosje të zbritura nga sektori i Trajtimit të Kërkesave për Njohje.
- Në zbatim të Memos Nr. 5154 Prot, datë 04.09.2023 mbi tërheqjen/kalimin nga sektori i Arkivës në Drejtorinë e Trajtimit të Kërkesave për Njohje Pronësie të dosjeve dhe praktikave/kërkesave, janë përgatitur me proces-verbal dhe dorëzuar **46** dosje dhe praktika/kërkesa.

- Janë realizuar **124** kërkesa të adresuara Sek/Arkivës në sistemin on-line (AMS)SQDNE.
- Janë skanuar vendimet gjyqësore të administruara me Memo nga arkiva në 47 dosje.
- Është realizuar vendosja në dispozicion e dokumentacionit si dhe Informacioni që kërkohet nga sektorët e tjerë të ATP-së për realizimin e kthim përgjigjeve.
- Është realizuar vendosja në dispozicion e dokumentacionit të njehsuar të 384 dosjeve, sektorit të përfaqësimit ligjor.
- Janë vënë në dispozicion **446** dosje Inspektorëve të sektorit Kompensimit Fizik dhe Financiar dhe sektorëve të tjerë të ATP-së.
- Në bazë të Urdhërit nr.37 dt.21.01.2025 për ngritjen e grupit të punës për sistemimin e vendimeve të ish KKKP pranë Bashkive dhe Këshillave të Rretheve si dhe ish ZRKKP të qarqeve përkatëse, të marra nga viti 1993 e në vijim,në dosjet respsktive. U nxorën dhe u kontrolluan 13075 dosje nga viti 1993 deri në vitin 2009 dhe vetëm 1049 vendime u futen nëpër dosjet përkatëse.
- Janë marrë në dorëzim nga sektori i Protokollit me procesverbalin nr.4599 dt.01.09.2025, 17 dosarë zyrtare viti 2020, 2 dosarë përfaqësimit ligjor viti 2020, 2 dosare viti 2019 njoftime, kërkesa për konfirmim, 1 dosar Zyrtare 2019 dhe 2 dosar përfaqësimi ligjor 2019.

6.3. Shërbime elektronike të ofruara nga ATP

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional të ATP-së me AKSHI-n dhe ADISA për krijimin dhe funksionimin e shërbimeve elektronike nga portali qeveritar e-albania, ATP ka vijuar punën me shërbimet elektronike të bëra publike:

- ▶ **Nga Portali e-Albania (AMS)**, janë trajtuar **1593 kërkesa/ankesa** qytetarësh të paraqitura nëpërmjet platformës e-Albania, nga të cilat:
 - **900 Ankesa** dhe trajtim i dosjes me specialistin përkatës;
 - **693 Kërkesa** për statusin dhe problematikat e dosjes.
 -
- ▶ **Sistemi i Qarkullimit të Dokumenteve me Nënshkrim Elektronik (SQDNE)**

Nuk ka patur aplikime zyrtare në SQDNE nga institucionet.

- ▶ Janë trajtuar **231kërkesë/ankesa** qytetarësh të paraqitura nëpërmjet platformës së **Bashkëqeverisjes**.
- ▶ Staf i ATP-së, si përdorues i Portalit Qeveritar “ONE STOP SHOP” merret me procedurat e ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve dhe akseson nga sistemi dokumente si çertifikata për qytetarët.

Indikatori	Janar - Dhjetor 2025
Shkresa qytetare në protokoll	5186
Aplikime qytetare në arkivë	796
Kërkesë/ankesa nga portali i Bashkëqeverisjes	231
Kërkesë/ankesa nga portali e-albania	1593
Shkresa trajtuar me SQDNE	0

Përgjatë vitit 2025, Agjencia e Trajtimit të Pronave ka vijuar procesin e identifikimit dhe përcaktimit të shërbimeve të tjera që do t'i ofrohen qytetarëve në mënyrë elektronike nga portali i Bashkëqeverisjes dhe e-albania. Nga stafi i ATP-së vazhdon të punohet bazuar në Manualin e Përdorimit të vendosur në dispozicion nga AKSHI “Sistemi i Qarkullimit të Dokumentave me Nënshkrim Elektronik”.

Manualin e Përdorimit të vendosur në dispozicion nga AKSHI “Sistemi i Qarkullimit të Dokumentave me Nënshkrim Elektronik”.

7. Analiza e buxhetit dhe fondeve speciale të kompensimit

7.1 Analiza e Buxhetit për 12 Mujorin e Vitit 2025

Buxheti i ATP për vitin 2025 është miratuar në bazë të ligjit të Buxhetit nr.115/2024 “Për Buxhetin e vitit 2024”, i ndryshuar me Aktin Normativ nr.11, datë 19.12.2025.

Plani për 12 Mujorin e Vitit 2025 është 2,369,315,953 lekë (dy miliardë e treqind e gjashtëdhjetë e nëntë milionë e treqind e pesëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e tre lekë).

Fakti për 12 Mujorin e Vitit 2025 është 2,353,652,448 lekë (dy miliardë e treqind e pesëdhjetë e tre milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e dy mijë e katërqind e dyzet e tetë lekë).

Nr	Emertime	Llog. Ekonomike.	Buxheti 2025 Aktit normativ nr.11,dt.19.12.2025	Fakti 12 - Mujor, Viti 2025	Realizimi në %
1	Paga shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli	600	196,600,000	196,201,496	100%
2	Kontributi i sigurimeve shoqerore dhe shendetësore	601	32,506,000	32,455,029	100%
3	Mallra dhe shërbime te tjera	602	41,432,000	29,330,308	71%
4	Transferime korrente të brendshme	604	2,095,140,000	2,095,140,000	100%
5	Transferta per Buxhetet familiare (Fondi Veçante))	606	368,000	255,662	69%
6	Shpenz. Për rritjen e aktivev të Trupëzuara	231	3,000,000		0%
7	Te Ardhura nga Vkmte tjera	604	269,953	269,953	100%
	Totali Buxhetor 1		2,369,315,953	2,353,652,448	99%
1	Te Ardhura Jashtë Buxhetore		905,000,000	951,540,857.70	105%

Kemi një realizimi në masën 99%.

1.Shpenzimet Buxhet 12- Mujorin e Vitit 2025

- (Artikulli 600) Paga shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli

Plani për 12 Mujorin e Vitit 2025 është 196,600,000 lekë (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e gjashtëqind mijë lekë).

Fakti për 12 Mujorin e Vitit 2025 është 196,201,496 lekë (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e dyqind e një mijë e katërqind e nëntëdhjetë e gjashtë lekë).

Kemi një realizimi në masën 100 % .

- (Artikulli 601) Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore

Plani për 12 Mujorin e Vitit 2025 është 32,506,600 lekë (tridhjetë e dy milionë e pesëqind e gjashtë mijë e gjashtëqind lekë).

Fakti për 12 Mujorin e Vitit 2025 është 32,455,029 lekë (tridhjetë e dy milionë e katërqind e pesëdhjetë e pesë mijë e njëzet e nëntë lekë).

Kemi një realizimi në masën 100 % .

- (Artikulli 602) Mallra dhe shërbime të tjera

Plani për 12 Mujorin e Vitit 2025 është 41,432,000 lekë (dyzet e një milionë e katërqind e tridhjetë e dy mijë lekë).

Fakti për 12 Mujorin e Vitit 2025 është 29,330,308 lekë (njëzet e nëntë milionë e treqind e tridhjetë mijë e treqind e tetë lekë).

Kemi një realizimi në masën 71 %.

Gjatë Vitit 2025 jemi bllokuar në thesar nga Përmbaruesit Privat, si pasojë ngelën 12 Urdhër Xhirime pa likuiduar, me vlerën prej 3,918,637 lekë. Urdhër Shpenzimet do të likujdohen me fondet e vitit 2026.

-Artikulli 604) Transferime korrente të brendshme

Plani për 12 Mujorin e Vitit 2025 është 2,095,140,000 lekë (dy miliardë e nëntëdhjetë e pesë milionë e njëqind e dyzet mijë lekë).

Fakti për 12 Mujorin e Vitit 2025 është 2,095,140,000 lekë (dy miliardë e nëntëdhjetë e pesë milionë e njëqind e dyzet mijë lekë).

Kemi një realizimi në masën 100 %.

-(Artikulli 606) Transferta për Buxhetet familjare Fondi Veçantë

Fond i Vecante (606)

Plani për 12 Mujorin e Vitit 2025 është 368,000 lekë (treqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë lekë)

Fakti për 12 Mujorin e Vitit 2025 është 255,662 lekë (dyqind e pesëdhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy lekë).

Kemi një realizimi në masën prej 69 %.

Të ardhurat jashtë Buxhetore

Plani për 12 Mujorin e Vitit 2025 është 905,000,000.00 lekë (nëntëqind e pesë milionë lekë).

Fakti për 12 Mujorin e Vitit 2025 është 951,540,857.70 lekë (nëntëqind e pesëdhjetë e një milionë e pesëqind e dyzet mijë e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë lekë e shtatëdhjetë qindarka).

1	Te Ardhura Jashtë Buxhetore		905,000,000	951,540,857.70	105%
	Totali Jashte Buxhetore 2		905,000,000	951,540,857.70	

Kemi një realizimi në masë 105%.

Këto janë të ardhura që derdhen nga ASHK në llogari të ATP

7.2 Informacion mbi të ardhurat nga tarifat që aplikohen në ATP, për 12 Mujorin e vitit 2025.

Nr	EMËRTIMI	Llog. Ekonomike.	Total	Komente
1	Tarifa për Aktet - Administrative	7110105	3,537,773.20	Perjudha 12 Mujore
2	Të ardhura nga tarifa per Zyren e Regjistrimit te Pasurive	7112300	350.00	Perjudha 12 Mujore
3	Derdhur gabim, të vitit në vazhdim	4664100		
4	Të tjera të ardhura sekondare dhe pagesa shërbimesh	7111099		
5	Të ardhura të krijuara nga pagesa e vlerës së llogaritur të tokës	7109901		
6	Të ardhura nga kalimi i pronësisë së pasurive të paluajtëshme e të truallit funksional të tyre	7109902		
7	Të ardhura nga privatizimi i banesave shtetërore dhe objekteve të kthyer në banesa me fondet e shoqërive shtetërore	7109903		
8	Të ardhura nga shitja - tokë , troje e terene	1161110	269,953.00	Perjudha 12 Mujore
9	Të tjera	7115499	14,270.40	Perjudha 12 Mujore
10	Te ardhura nga Transferimi i prones nga legalizimi I ndertimeve pa leje 70%	7116101	927,927,208.05	Perjudha 12 Mujore
11	Te ardhura nga Transferimi i prones nga legalizimi I ndertimeve pa leje 50%	7116102	10,443,644.00	Perjudha 12 Mujore
TOTAL			942,193,198.65	

Informacioni për të ardhurat 12 Mujorin e Vitit 2025

Totali 4+5+6+7+8	269,953	Të ardhura që i shtohen ATP në fondin e kompensimit, në pritje për kalimin në thesar për në bankën e Shqipërisë rritja e Autorizuar.
Totali 10+11	938,370,852.05	Të ardhura që i shtohen ATP për kompensimin e pronarëve për tokat e zëna nga ndërtimet informale (Aluizni), për vitin 2025

- Tarifa për Aktet – Administrative Llogaria ekonomike 7110105 – 3,537,773.20 derdhen në Buxhet të Shtetit
- Tarifa për Aktet – Administrative Llogaria ekonomike 7112300 – 350.00 derdhen në Buxhet të Shtetit

- Tarifa për Aktet – Administrative Llogaria ekonomike 7115499 – 14.270.40 derdhen në Buxhet të Shtetit
- Të ardhura nga shitja - tokë , troje e terene Llogaria ekonomike 1161110 – 269,953 lekë. Për këtë shumë do të bëhet tërheqje e Autorizuar dhe i shtohet fondit special për kompensimin e pronarëve sipas ligjit 133/2015 të ndryshuar.
- Të ardhura nga Transferimi i pronës nga legalizimi i ndërtimeve pa leje 70% Llogaria ekonomike 7116101 – 927,927,208.05 lekë
- Të ardhura nga Transferimi i pronës nga legalizimi i ndërtimeve pa leje 50% Llogaria ekonomike 7116102 – 10,443,644.00 lekë

7.3 Informacionin Sa lekë janë shpenzuar për Aluiznin dhe Kompensim financiar dhe me Kërkesë të veçantë gjatë 12 Mujorit të Vitit 2025.

Totali 2025	4,087,872,858.31	Nr.Subjekteve	Nr.Subjekteve/ mbyllje procedimi
Xhirime Aluzini	3,772,725,129.97	5,946	
Raste Te vecanta	257,155,845.63	59	1
Kompensim financiar 20 me 80	36,945,156.44	10	5
Kompensim financiar me masa 100%	21,046,726.27	27	0

Gjatë 12 Mujorit të Vitit 2025 janë kompensuar Kompensim Financiar si më poshtë:

-59 Subjekte me Kërkesë të Vecantë me vlerën prej 257,155,845.63 lekë (dyqind e pesëdhjetë e shtatë milionë e njëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e dyzet e pesë lekë dhe gjashtëdhjetë e tre qindarka) dhe 1 Subjekt Mbyllje Proçedimi.

-10 Subjekte që përfitojnë Kompensim Financiar dhe Fizik (20 me 80) me vlerë 36,945,156.44 lekë (tridhjetë e gjashtë milionë e nëntëqind e dyzet e pesë mijë e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë lekë dhe dyzet e katër qindarka) dhe 5 Subjekte Mbyllje Proçedimi.

-27 Subjekte që përfitojnë Kompensim Financiar në masën 100% me vlerë 21,046,726.27 lekë (njëzet e një milionë e dyzet e gjashtë mijë e shtatëqind e njëzet e gjashtë lekë dhe njëzet e shtatë qindarka).

Gjatë 12 Mujorit të Vitit 2025 janë kompensuar Kompensim Financiar nga Ndërtimet Informale si më poshtë:

- 5946 Subjekte që kanë përfituar kompensim që preken nga ndërtimet informale me vlerën prej 3,772,725,159.97 lekë (tre miliardë e shtatëqind e shtatëdhjetë e dy milionë e shtatëqind e njëzet e pesë mijë e njëqind e pesëdhjetë e nëntë lekë dhe nëntëdhjetë e shtatë qindarka) (ALUIZNI).

- Gjatë Vitit 2024 nga Buxheti i Shtetit u dha një fond prej 3,095,140,000 lekë (tre miliardë e nëntëdhjetë e pesë milionë e njëqind e dyzet mijë lekë) për të kompensuar në masën 30% subjekte që preken nga ndërtimet informale.

- Me Vendimin nr.223, dt.30.12.2024 “Lista e subjekteve, që përfitojnë këstin e fundit (30%) të kompensimit/shpërblimit, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimet informale”, ku janë kompensuar 5320 subjekte me vlerën 3,095,139,163.84 lekë (tre miliardë e nëntëdhjetë e pesë milionë e njëqind e tridhjetë e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e tre lekë dhe tetëdhjetë e katër qindarka), por likuidimin në bankën e nivelit të dytë u bë në dt.07.01.2025.

626 Subjekte në masën 70%, me vlerë 677,585,966.13 lekë (gjashtëqind e shtatëdhjetë e shtatë milionë e pesëqind e tetëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë lekë dhe trembëdhjetë qindarka) Kompensim nga Ndërtimet Informale (ALUIZNI).